



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHËTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Dokument i shkurtë për politika publike nr.18/2021


-

Korrik 2020 - korrik 2021:
Një vit pas zgjedhjeve parlamentare,
si e shohin qytetarët ndikimin politik
dhe nivelin e hapjes së përbërjes
aktuale parlamentare?

Autore: Vlora Reçica dhe Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq

-

korrik 2021



Ky publikim është përpiluar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PSP implementohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci “Societas Civis” - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN). Përmbajtja e botimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e SDC-së.

1. Hyrje

Parlamentet ekzistojnë për të siguruar perspektivën e qytetarëve në ushtrimin e sovranitetit të tyre si dhe për të reflektuar dhe monitoruar nga afër punën e pushtetit ekzekutiv. Qytetarët, bazuar në gjykimin e tyre personal mbi sukseset ose dështimet e punës së deputetëve dhe pushtetit ekzekutiv, marrin vendim dhe japin votën e tyre në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Partia ose koalicioni me numrin më të madh të vendeve të deputetëve merr mandat për të formuar Qeverinë e saj dhe për të menaxhuar burimet e shtetit në periudhën e ardhshme. Së këndejmi, perceptimet e qytetarëve janë tregues të fuqishëm, të cilët krijojnë presion shtesë mbi institucionet politike, pasi ato formësojnë rezultatet e zgjedhjeve dhe çojnë në zgjedhje ose rënie të strukturave qeverisëse. Prandaj, konsultimi i herëpashershëm i qytetarëve për perceptimin e tyre në lidhje me punën e Kuvendit është një qasje e domosdoshme dhe origjinale në informacionet për deputetët. Në këtë mënyrë, të zgjedhurit e popullit mund të kenë një pasqyrë të përgjithshme në lidhje me qëndrimet pozitive dhe negative të publikut për fushat specifike të punës së tyre, si dhe të marrin udhëzime dhe rekomandime të vlefshme për zhvillimin e ardhshëm.

Përbërja aktuale, e dhjetë, parlamentare e Kuvendit u zgjodh në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 15 korrik 2020. Në këto zgjedhje,

LSDM dhe koalicioni "Mundemi" - fituan 46 deputetë, VMRO-DPMNE dhe koalicioni "Ripërtëritje për Maqedoninë" - fituan 44 deputetë, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) fitoi 15 deputetë, koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa fitoi 12 deputetë, e Majta fitoi 2 deputetë, ndërsa Partia Demokratike e Shqiptarëve fitoi 1 deputet. Koalicioni qeveritar u formua midis LSDM-së dhe koalicionit "Mundemi" dhe BDI-së, si dhe PDSH-së, i cili siguroi shumicën në Kuvend me 62 deputetë. Në zgjedhjet, 80 nga gjithsej 120 deputetë të zgjedhur ishin të rinj, përkatësisht ata u gjetën në rolin e deputetit për herë të parë në karrierën e tyre.

Për 13 vjet, Instituti për Demokraci, monitoron vazhdimisht perceptimin e qytetarëve për punën e Kuvendit. Në periudhën shkurt-mars 2021, në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), u krye anketë vjetore në terren në lidhje me punën e përbërjes së re parlamentare të votuar në korrik 2020. Qëllimi i kësaj analize të shkurtër është të jap një pasqyrë krahasuese të pikëpamjeve të qytetarëve mbi rolin dhe hapjen e Kuvendit me përbërjen aktuale parlamentare në raport me përbërjet e mëparshme parlamentare në periudhën 2016 - 2021. Përmes këtij teksti, do të identifikohen disa çështje me potencial për përmirësim dhe do të jepen rekomandime se si të mundësohet ai përmirësim.


2. Roli i Kuvendit në jetën politike të Maqedonisë së Veriut

Kuvendi, si organi më i lartë përfaqësues përmes të cilit qytetarët ushtrojnë pushtetin e tyre, ka fuqinë më të gjerë dhe më autonome në vend. Kompetencat e dhomës ligjvënëse janë burimore dhe të përcaktuara me kushtetutë, dhe ky rregullim në sistemin politik të Maqedonisë së Veriut, i mundëson të luajë një rol të rëndësishëm kur bëhet fjalë për krijimin e jetës shoqërore dhe ekonomike.

Shumica e qytetarëve e identifikojnë rolin e rëndësishëm të Kuvendit në jetën politike të vendit. Kjo pikëpamje është konfirmuar në rezultatet e anketës së kryer në vitin 2021. Kështu, në pesë vitet e fundit, numri i qytetarëve që besojnë se Kuvendi ka një rol të rëndësishëm në jetën politike të vendit, vazhdimisht lëviz në rreth dy të tretat

dhe më shumë se numri i përgjithshëm i qytetarëve. Përmes një analize më të detajuar mund të vërehet se në tre vitet e fundit, ky perceptim tek qytetarët po rritet, duke arritur kulmin e tij në vitin 2021, kur rreth 73% e qytetarëve thanë se sipas tyre Kuvendi luan një rol të rëndësishëm në jetën politike të vendit. Në mënyrë përkatëse me këtë, në tre vitet e fundit, përqindja e qytetarëve që besojnë se Kuvendi luan rol të parëndësishëm në jetën politike të vendit po bie vazhdimisht, duke arritur 23 përqind në vitin 2021 (Grafiku 1). Kjo tendencë pozitive në rritje në identifikimin e Kuvendit si aktor të rëndësishëm në jetën politike të vendit, është indikator se te qytetarët ndërtohet perceptim për rëndësinë e ndarjes së pushteteve dhe ndikimin thelbësor të dhomës ligjvënëse në hartimin e politikave.

Grafiku 1. Cili është roli i Kuvendit në jetën politike në Maqedoninë e Veriut (%)




Paralelisht me trendin në rritje në identifikimin e rolit të rëndësishëm që ka dhoma ligjvënëse në jetën politike, po rritet përqindja e qytetarëve që besojnë se Kuvendi është i gatshëm të zbatojë reformat dhe të normalizojë situatën politike në vend. Kështu, për sa i përket gatishmërisë për zbatim të proceseve të reformës që fillimisht u paralajmëruan pas formimit të shumicës parlamentare dhe Qeverisë në vitin 2017, në vitin 2021 u vërejt optimizëm më i madh tek qytetarët.

Rezultatet e anketës së realizuar në vitin 2021 tregojnë se përqindja e qytetarëve të cilët pjesërisht

ose plotësisht pajtohen se Kuvendi është i gatshëm të zbatojë reformat është për 5 pikë të përqindjes më e lartë krahasuar me vitin 2020 (41%), dhe 3 përkatësisht 2 pikë të përqindjes më e lartë në vitin 2019 dhe 2018, në mënyrë përkatëse. Si pasojë, në vitin 2021 vërehet rënie e numrit të qytetarëve që janë plotësisht ose pjesërisht të bindur se Kuvendi nuk është i gatshëm të zbatojë reformat dhe të normalizojë situatën politike. Gjegjësisht, nga 48% në vitin 2020 dhe 49% në vitin 2019, kjo përqindje ka rënie për 6 përkatësisht 7 pikë të përqindjes në mënyrë përkatëse, dhe në vitin 2021 është 42% (Grafiku 2).

Grafiku 2. Kuvendi është i gatshëm të zbatojë reformat dhe të normalizojë situatën politike (%)



Rritja e perceptimit pozitiv në vitin 2021 për gatishmërinë e Kuvendit të zbatojë reforma, tregon se qytetarët identifikojnë rritjen e kushteve për efikasitet dhe efektivitet më të madh në ushtrimin e funksioneve të pushtetit ligjvënës. Pavarësia financiare dhe administrative e shërbimit të Kuvendit,


që me konsensus të gjerë politik u votua në janar 2020 gjithashtu do t'i japë mbështetje plotësuese Kuvendit drejt përmbushjes së kompetencave dhe rolit të tij në jetën politike. Kjo mospërputhje pozitive duhet të ruhet dhe zhvillohet më tej nga kjo përbërje parlamentare, në mënyrë që të rritet

besimi në Kuvendin si pushteti më i lartë në vend.

Një ndryshim pozitiv është vërejtur edhe në lidhje me aspektin e perceptimit të qytetarëve nëse Kuvendi ka ndikim mbi cilësinë e ligjeve që i miraton. Gjegjësisht, në vitin 2021, më shumë se dy të tretat (68%) e të anketuarve deklaruan se Kuvendi ka ndikim mesatar ose shumë të lartë mbi cilësinë e ligjeve, që është përqindja më e lartë në gjashtë vitet e fundit. Nga ana tjetër, në mënyrë përkatëse përqindja e të anketuarve që besojnë se Kuvendi mesatarisht nuk ndikon mbi cilësinë

e ligjeve në Maqedoninë e Veriut në vitin 2021 është 29%, që pas vitit 2017 kur kjo përqindje ishte 24%, është më e ulëta (Grafiku 3). Kjo tendencë në rritje tregon se numër gjithnjë e më i madh i qytetarëve besojnë se Kuvendi ndikon mbi kornizën normative përmes adaptimit shtesë të ligjeve. Perceptimi i qytetarëve për rëndësinë e Kuvendit në procesin legjislativ varet nga përpjekjet e vazhdueshme të deputetëve për të përdorur funksionin e tyre ligjvënës në interes të qytetarëve.

Grafiku 3. A ndikon Kuvendi në cilësinë e ligjeve në vendin tonë? (%)




3. Kuvend i hapur

Për të përmbushur mandatin e tij përfaqësues, Kuvendi duhet të jetë në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët. Një pjesë e këtij angazhimi përfshin takime dhe konsultime, përfshirje aktive të publikut në punën e tyre, si dhe transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve. Qytetarët kanë të drejtë të kenë qasje të lehtë dhe të shpejtë në informacione për punën e Kuvendit si dhe të informohen për mekanizmat e përfshirjes në punën e Kuvendit dhe të inkurajohen t'i praktikojnë ato.

Rezultatet e analizës së bërë në vitin 2021, tregojnë se sipas publikut, përbërja e re parlamentare është më e arritshme për komunikim me qytetarët, krahasuar me deputetët e mëparshëm në gjashtë vitet e fundit. Gjegjesisht, gati një e treta (30%) e

qytetarëve mendojnë se deputetët nga njësia e tyre elektorale janë në dispozicion për takim me publikun. Krahasuar me rezultatet e anketave të kryera në vitin 2020 dhe 2019, vërehet rritje e konsiderueshme e këtij perceptimi pozitiv me 9 pikë të përqindjes. Në përputhje me këtë, duke marrë parasysh gjashtë vitet e fundit, në vitin 2021 është vërejtur përqindja më e ulët e qytetarëve që besojnë se deputetët nuk janë në dispozicion për takim me qytetarët edhe është 45%, që paraqet rënie me 8 pikë të përqindjes krahasuar me vitin 2020 dhe 2019 (53%; Grafiku 4) Megjithatë kjo përqindje e qytetarëve që nuk janë të bindur në disponueshmërinë e deputetëve mbetet e lartë, megjithatë ulje kaq e konsiderueshme paraqet tregues pozitiv për përmirësim të mundshëm të situatës në këtë fushë.


Grafiku 4. Deputeti/ja nga rajoni juaj (komuna, njësia zgjedhore) a është në dispozicion për takime me qytetarë (%)



Ky perceptim i publikut mbështetet nga fakti që në vitin 2021 më shumë se dy të tretat (68%) e qytetarëve e dinin se kush ishin përfaqësuesit e zgjedhur nga njësia e tyre zgjedhore. Kjo përqindje është dukshëm më e lartë se çdo përqindje tjetër në gjashtë vitet e fundit në raport me këtë çështje, përkatësisht është më e lartë për më shumë se

9 pikë të përqindjes krahasuar me ndonjë nga gjashtë vitet e mëparshme. Konkretisht, krahasuar me rezultatet e vitit 2020 dhe 2019, në vitin 2021 kishte një rritje madje për 17 përkatësisht 14 pikë të përqindjes, të qytetarëve që njohin deputetët dhe deputetet nga njësia e tyre zgjedhore (Grafiku 5).

Grafiku 5. A e dini kush është deputet/ e nga njësia juaj zgjedhore? (%)




Duke marrë parasysh që çështjet lokale janë me rëndësi të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme për jetën e përditshme të qytetarëve dhe qytetarët mund të identifikohen më lehtë me to, anketa gjithashtu hulumtoi perceptimin e publikut se sa deputetët i kushtojnë vëmendje çështjeve lokale në Kuvend. Edhe në lidhje me këtë çështje, vërehet trend pozitiv

në rritje në 3 vitet e fundit. Në vitin 2021, 21% e të anketuarve thanë se deputetët nga njësia e tyre elektorale kanë iniciuar një çështje që ndikon drejtpërdrejt komunën e tyre. Krahasuar me vitin 2019 (14%) dhe 2020 (15%), analiza e fundit e vitit 2021 tregon rritje prej 7 dhe 6 pikë të përqindjes në lidhje me këtë çështje. Në mënyrë përkatëse,

përqindja e qytetarëve që mendojnë se deputetët nuk merren me problemet lokale me të cilat përballet komuna e tyre, ka rënë ndjeshëm në tre vitet e fundit, duke arritur 43% në vitin 2021, e cila pavarësisht rezultatit në vitin 2016 (42%) është më e ulëta në

gjashtë vitet e fundit. Konkretisht, krahasuar me vitin 2019 (59%) dhe 2020 (53%), në vitin 2021 shënohet rënie përkatësisht me 16 dhe 10 pikë të përqindjes në mënyrë përkatëse, në lidhje me këtë perceptim negativ të qytetarëve (Grafiku 6).

Grafiku 6. A ka ndodhur që deputeti/ja nga rajoni juaj të ketë iniciuar një çështje në Kuvend për një problem me të cilin po përballet komuna juaj? (%)



Rezultatet e anketës së kryer në vitin 2021, krahasuar me katër vitet e fundit, tregojnë një rritje të lehtë të perceptimit pozitiv në lidhje me atë se deputetët përfshijnë vërejtjet e publikut në miratimin e ligjeve dhe ulje përkatëse të përqindjes së qytetarëve që mendojnë se kjo kurrë nuk ka ndodhur. Gjegjësisht, 16% e të anketuarve në vitin 2021 thanë se deputetët gjithmonë ose shpesh marrin parasysh


vërejtjet e publikut dhe organizatave të shoqërisë civile gjatë miratimit të ligjeve, e cila është për 4 ose 5 pikë të përqindjes më shumë, krahasuar me vitin 2020 ose 2019 në mënyrë përkatëse. Nga ana tjetër, pothuajse e njëjta përqindje e të anketuarve, 17%, në vitin 2021 deklaruan se deputetët kurrë nuk marrin parasysh mendimin e qytetarëve, që përkundër rezultatit të vitit 2016 (18%) është më i ulët në

gjastë vitet e fundit, ndërsa krahasuar me vitin 2020 (24%) shënon rënie të ndjeshme prej 7 pikë të përqindjes.

Ky hap pozitiv në vitin 2021, në lidhje me atë se sa qytetarët mendojnë se deputetët i përfshijnë

vërejtjet e tyre gjatë përgatitjes së ligjeve, është veçanërisht i rëndësishëm për të ruajtur dhe rritur vazhdimisht mandatin e kësaj përbërje parlamentare. Për qytetarët është e rëndësishme që mendimi i tyre realisht të merret parasysh dhe të shndërrohet në kornizën normative të shtetit.

Grafiku 7. Sa shpesh deputetët përfshijnë vërejtjet e publikut dhe organizatat e shoqërisë civile gjatë hartimit të ligjeve? (%)



4. Përfundim dhe rekomandime

Në vitin 2021, vërehet hap pozitiv përpara në qëndrimet e qytetarëve kur bëhet fjalë për rolin e Kuvendit në jetën politike të vendit, disponueshmërinë e të zgjedhurve të popullit për publikun dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes. Gjegjësisht, ky mandat parlamentar njihet nga publiku si më me ndikimin në jetën politike dhe cilësinë e kornizës normative të Maqedonisë së Veriut që nga viti 2016 e tutje, dhe më i gatshmi për zbatimin e reformave dhe normalizimin e jetës politike në vend. Qytetarët gjithashtu vlerësuan se deputetët aktualë janë më të arritshëm për komunikim me qytetarët, ndërsa krahasuar me kolegët e tyre nga mandatet e mëparshme, ata kanë më shumë sens për nevojat e drejtpërdrejta lokale të qytetarëve, dhe deri në një farë mase marrin më shumë parasysht vërejtjet e bëra nga publiku.

Megjithatë, këto trende pozitive janë në fillimet e tyre dhe duhen përpjekje dhe vullnet shtesë nga ana e deputetëve për të ruajtur dhe përmirësuar këtë situatë. Në vazhdim disa rekomandime si të arrihet kjo:

- **Kuvendi duhet të bëjë përpjekje serioze për avancimin e cilësisë së kryerjes së funksioneve të tij të përcaktuara me kushtetutë, dhe mbi të gjitha funksionin mbikëqyrës.** Deputetët duhet të praktikojnë në mënyrë aktive dhe thelbësore mekanizmat për mbikëqyrje, që i kanë në dispozicion të tyre. Në atë mënyrë, ndikimi dhe roli i Kuvendit në jetën politike të vendit do të rritet ndjeshëm.
- **Rritja e informimit dhe njohurive mbi temat që janë objekt diskutimi në Kuvend, si dhe përmirësimi i aftësive debatuuese dhe oratorike të deputetëve.** Në këtë mënyrë,

deputetët do të jenë në gjendje të marrin vendime më të informuara, të shpjegojnë më mirë pretendimet e tyre përmes argumenteve para kolegëve të tyre, ndërsa me këtë të ndikojnë më tej në cilësinë e ligjeve që i miratojnë.

Instituti Parlamentar (IP), i cili vepron në suazat e Kuvendit, kryen kërkime mbi tema me interes për deputetët, si dhe edukim dhe trajnim në fusha specifike. Së këndejmi, paraqitet nevoja për përdorim më të madh dhe më efektiv të shërbimeve të IP-së nga deputetët. Për më tepër, ekziston nevoja për të rritur bashkëpunimin me sektorin e shoqërisë civile, i cili ka ekspertizë dhe njohuri për tema specifike, të cilat mund të ndihmojnë ndjeshëm deputetët në procesin e vendimmarrjes.

- **Kuvendi duhet të azhurnojë vazhdimisht mekanizmat dhe praktikat për mbajtjen e kontakteve të ngushta dhe të drejtpërdrejta me qytetarët.** Publiku duhet të ketë këqyrje të papenguar dhe të rregullt mbi punën e Kuvendit, si dhe kanal të hapur për komunikim të dyanshëm me përfaqësuesit e tyre. Kjo mund të arrihet përmes përmirësimit të përmbytjes dhe mjeteve për informimin e publikut për Kuvendin (për shembull kanalin i Kuvendit, ueb faqja e Kuvendit dhe profilet në mediat sociale), si dhe aktivizimin e zyrave ekzistuese për kontakt me qytetarët të vendosura në komunat në të gjithë shtetin. Kuvendi gjithashtu duhet të intensifikojë edhe edukimin e qytetarëve për mekanizmat ekzistues për përfshirjen e tyre në punën e Kuvendit.



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHËTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Dokument i shkurtë për politika publike nr.18/2021

-

Korrik 2020 - korrik 2021:

**Një vit pas zgjedhjeve parlamentare,
si e shohin qytetarët ndikimin politik
dhe nivelin e hapjes së përbërjes
aktuale parlamentare?**

Autore: Vlora Reçica dhe Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq

-

korrik 2021